

ALBAN.DEL SH.P.K.

SELIA: TORRE DRIN, RR. ABDI TOPTANI, KATI II, TIRANË  
KAPITALI THEMELTAR: 20.000,00 EURO  
NIUS: K91825012J

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
NR. 4677 REP.  
NR. 797 KOL.

VENDIMI I ASAMBLESË SË JASHTËZAKOSHME TË  
ORTAKËVE TË SHOQËRISË  
"ALBAN.DEL" SH.P.K.

Sot, më 5 gusht 2010, në orën 10.00, pranë selisë ligjore të shoqërise "ALBAN.DEL" Sh.p.k (në vijim "Shoqërla"), perpara meje, Noteres G. Silvanoq mbledhet Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë pas një rregullt për tu mbledhur, dërguar më datë 27 korrik 2010.

Una Noterja, pasi bera verifikimet perkatese te kerkuara nga Ligji, u seigurova per identitetin, cilesine che aftesine e ortakeve.

Eshtë e pranishme, TOD'S INTERNATIONAL BV, shoqëri e së drejtës holandeze me përgjegjësi të kufizuar, me selli në Amsterdam, P. Cornelisz Hooftstr 74, 1071CB, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Amsterdemit, me numër 33289506, e cila zotëron 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë (në vijim "Ortaku i Vetëm"), e përfaqësuar prej Znj. Aurela Bakushi, lindur më 7 Shtator 1975, në Përmet (Shqipëri), në bazë të vendimit të Këshillit të Administrimit të TOD'S INTERNATIONAL BV më datë 27 korrik 2010.

Znj. Aurela Bakushi, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhje, fton Z. Enklid Milaj, i lindur më 31 Gusht 1975, Fier (Shqipëri), me vendbanim në Tiranë, gjithashtu i pranishëm, që të kryejë funksionin e sekretarit dhe ky i fundit pranon.

Kryetari konstaton:

- irregullsinë e mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqërisë;
  - praninë e një autorizimi të vlefshme nga Ortaku i Vetëm;
  - mungesën e justifikuar të administratorit të vetëm të Shoqërisë z. Stefano Sincini;
- dhe e deklaron Asamblenë e Ortakëve të Shoqërisë (në vijim "Asambleja") të mbledhur rregullisht për të diskutuar dhe marrë vendime si më poshtë vijon:

Rendi i Ditës

1. ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË ALBAN.DEL SH.P.K.; DHE
2. TË NDRYSHME.

\*\*\*\*\*

1. ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRISË ALBAN.DEL SH.P.K.





## ALBAN.DEL SH.P.K.

SELIA: TORRE DRIN, RR. ABDI TOPTANI, KATI II, TIRANË  
KAPITALI THEMELTAR: 20.000,00 EURO  
NIUS: K91825012J

Duke iu referuar pikës së parë të Rendit të Ditës, Kryetari informon Asamblenë në lidhje me vendimin e Ortakut të Vetëm për zmadhimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Pasi verifikoi situatën financiare të Shoqërisë, Ortaku i Vetëm gjykon se është në interesin më të mirë të Shoqërisë zmadhimi i kapitalit të saj themeltar nëpërmjet injektimit të një shume në para të barabartë me Euro 700.000 (shtatëqind mijë Euro) i barabarte me shumen ekuivalente ne Leke Shqiptare sipas kursit te shkembimit te dites.

Kryetari (në përfaqësim të Ortakut të Vetëm) thekson faktin se, zmadhimi kapitalit do të nënshkruhet tërësisht nga Ortaku i Vetëm dhe do të paguhet nëpërmjet dardhjes në llogarinë bankare të Shoqërisë, e cila gjendet pranë Bankës Veneto Banka, të shumës totale të barabartë me Euro 700.000 (shtatëqind mijë Euro) dhe i propozon Asamblese të aprovojë operacionin në fjalë.

Pas një vlerësimi të matur dhe një diskutimi të gjërë mbi çështjen, Asambleja unanimisht:

### VENDOS

- të aprovojë zmadhimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë Alban,Del Sh.p.k. me një kontribut në para të barabartë me Euro 700.000 (shtatëqind mijë Euro) i cili i korrespondon nr. 7.000 (shtatë mijë) kuotash të reja me një vlerë nominale prej Euro 100 (njëqind) secila.  
Kuotat e reja do të nënshkruhen dhe do të paguhën tërësisht nga Ortaku i Vetëm brenda 2 ditësh nga marja e këtij vendimi, nëpërmjet derdhjes së shumës përkatëse në llogarinë e Shoqërisë, e cila gjendet pranë Bankës Veneto Banka, dhe do të shprehen në Lekë sipas kursit të këmbimit të aplikuar në bankë; dhe
- të ndryshojë, rrjedhimisht, nenin 6 che 7 të Statutit të Shoqërisë si më poshtë vijon:

### Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar është i barabartë me Euro 720.000,00 (shtatëqindenjëzet mijë Euro).
- 6.2 Kapitali themeltar përbëhet nga 7.200 (shtatëmijë e dyqind) kuota të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera, me një vlerë prej Euro 100 (njëqind) secila.

### Neni 7 – Kontributet dhe kuotat

- 7.1 Kapitali themeltar është tërësisht i nënshkrua dhe i paguar si më poshtë vijon:
  - TOD'S INTERNATIONAL BV, ka kontribuar me një shumë prej Euro 720.000,00 (shtatëqindenjëzet mijë Euro).
- 7.2 Sipas kontributit të mësipërm:
  - Shoqërisë TOD'S INTERNATIONAL BV i përkasin 7.200 (shtatëmijë e dyqind) kuota, që i korrespondojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

ALBAN.DEL SH.P.K.

SELIA: TORRE DRIN, RR. ABDI TOPTANI, KATI II, TIRANË  
KAPITALI THEMELTAR: 20.000,00 EURO  
NIUS: K91825012J

2. TË NDRYSHME

Duke iu referuar pikës së dytë dhe fundit të Rendit të Ditës, Kryetari propozon që Asambleja të autorizojë një person për depozitimin e vendimit të Asamblesë, pika e parë në Rendit të Ditës, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit apo pranë organeve të tjera kompetente të administratës publike, përfshirë këtu edhe organet tatimore, nëse kërkohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Pasi diskutoi mbi çështjen, Asambleja:

VENDOS

të autorizojë Znj. Aurela Bakushi dhe Znj. Gerta Ylli që të ndërmarrin, individualisht, të gjitha veprimet dhe/ose procedurat e nevojshme, të paraqesin kërkesa si edhe çdo dokument tjetër të kërkuar për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit apo pranë organeve të tjera kompetente të administratës publike, përfshirë këtu edhe organet tatimore, apo të autorizojnë persona të tjere për këtë qëllim.

\*\*\*\*\*

Duke qenë se nuk ka çështje të tjera për të diskutuar dhe duke qenë se askush nuk e kërkoi fjalën, Kryetarja e deklaron mbledhjen e Asamblesë të mbyllur në orën 10.30.

\*\*\*\*\*

Ky akt, pasi u redaktua prej meje Noterës, iu lexua te pranishmeve te cilet e degjuan dhe e miratuan. Akti nenshkruehet lirisht nga palet në prenime time dhe una noterja e vertetoje në baze të ligjit.

KRYETARI

  
Aurela Bakushi

NOTERE

SEKRETARI

  
Enklid Milaj